



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
KOSOVA HANDBALL FEDERATION
RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

RREGULLORJA PUNËS SË BORDIT TË FHK-së

Federata e Hendbollit e Kosovës

10000 Pristina, Republic of Kosovo

Tel: +383 38 248 758

Fax: +383 38 248 759

Email: office@kosovahandball.info

Web: www.kosovahandball.info

Në bazë të dispozitave të nenit 6 të Statutit të Federatës së Hendbollit të Kosovës dhe nenit 7 të Rregullores së Punës së Bordit të Federatës së Hendbollit të Kosovës, Bordi i Federatës së Hendbollit (në tekstin e mëtejme "Bordi i FHK- së") në mbledhjen së vet të datës 01.10.2022 e ka miratuar këtë:

RREGULLORE TË PUNËS SË BORDIT TË FEDERATËS SË HENDBOLLIT TË KOSOVËS

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Bordi i FHK-së është organi më i lartë Ekzekutiv i Federatës së Hendbollit të Kosovës.
2. Presidentin, nën/presidentin dhe katër anëtarët e Bordit të FHK-së- i zgjedhë Kuvendi i Federatës së Hendbollit të Kosovës, ndërsa tre anëtarë tjerë të Bordit i emëron Kryetari i Bordit të FHK-së, në pajtim me Statutin e Federatës së Hendbollit të Kosovës. Kurse kryetarët e Shoqatës së gjyqtarëve dhe Shoqatës së trajnerëve automatikisht janë anëtarë të Bordit të FHK-së.
3. Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi apo dorëheqja e anëtarëve të Bordit të FHK-së bëhen në pajtim me Statutin e FHK-së dhe aktet tjera normative të FHK-së.
4. Për punën dhe funksionimin e vet, Bordi i FHK-së i përgjigjet Kuvendit të FHK-së.

Neni 2

Përgjegjësitë e Bordit

1. Bordi i FHK-së obligohet që t'i kryejë të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga Statuti dhe aktet tjera normative të Federatës së Hendbollit të Kosovës.
2. Në pajtim me Statutin e FHK-së, Bordi i FHK-së ushtron përgjegjësitë në vijim:
 - a) Bie vendimin mbi konvokimin e Kuvendit të FHK-së dhe propozon rendin e ditës për mbledhjen e Kuvendit të FHK-së.
 - b) Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera normative të cilat miratohen nga Kuvendi i FHK-së.
 - c) Nxjerr Rregulloren mbi regjistrimin dhe licencimin e klubeve dhe shoqatave.
 - d) Ekzekuton vendimet dhe konkluzionet e Kuvendit të FHK-së
 - e) Bie Rregulloren mbi punën e Bordit të FHK-së.
 - f) Përpilon Planin e punës dhe Planin financiar vjetor të FHK-së.
 - g) Ekzekuton politikën e përgjithshme të FHK-së.
 - h) Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm të FHK-së.
 - i) Emëron dhe shkarkon anëtarët e trupave punuese të Bordit të FHK-së.
 - j) Vendosë mbi blerjen dhe shitjen e pasurisë së Federatës.
 - k) Miraton listat e zyrtarëve (gjyqtarëve, vëzhguesve dhe kontrollorëve) të ndeshjeve.

- l) Nxjerr Rregulloret e brendshme të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit të FHK-së.
- m) Shqyrton dhe miraton Planprogramin e Këshillit Profesional të FHK-s.
- n) Bie Rregulloren mbi punën e reprezentacioneve të FHK-së.
- o) Emëron dhe shkarkon Komisarën e Garave.
- p) Miraton kalendarin dhe Propozicionet e Garave.
- q) Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës.
- r) Cakton lartësinë e taksës për zyrtarët e ndeshjeve.
- s) Cakton lartësinë e kuotizimit për klubet dhe çmimet e shërbimeve të cilat i kryen Federata për klubet.
- t) Nxjerr Rregulloren mbi sistematizimin e vendeve të punës.
- u) Vendos për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve për kryerjen e punëve të përhershme dhe përkohshme në FHK, si dhe lartësinë e pagave të tyre.
- v) Nxjerr Rregulloren për punën e Komisionit Arbitrar, si organ i shkallës së dytë.
- w) Bordi i FHK-së mund të vendosë edhe për çështjet e tjera për të cilat e autorizon Kuvendi ose të cilat janë të parapara në Statutin e FHK-së.

Neni 3

Delegimi i kompetencave të Bordit

1. Bordi i FHK-së mund të krijojë këshilla dhe komisione ad hoc, në rast se të njëjtat konsiderohen si të domosdoshme për funksionimin e tij. Në rast të tillë, Bordi do t'ua përcaktojë të atyre detyrat, kohëgjatësinë, kompetencat dhe fushëveprimtarinë funksionale. Puna në trupa të tilla punuese do të zhvillohet në analogji me procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Bordi i FHK-së mund t'ia delegojë kryerjen e një detyre edhe një personi të vetëm.
3. Bordi i FHK-së mund t'i autorizojë punonjësit administrativ apo profesional të FHK-së që të kryejë ndonjë punë që është nën kompetencën e Bordit të FHK-së.

Neni 4

Sekretari i Bordit të FHK-së

1. Sekretari i FHK-së shërben edhe si Sekretar i Bordit të FHK-së dhe merr pjesë në të gjitha takimet e tij.
2. Sekretari i Bordit të FHK-së është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve nga takimet e Bordit, për mbarëvajtjen e korrespondencës me shkrim mes Bordit dhe anëtarëve dhe komisioneve të veta, dhe për dërgimin e ftesave dhe rendit të ditës tek anëtarët e Bordit.
3. Sekretari i Bordit të FHK-së është përgjegjës për formulimin e vendimeve të miratuara në Bord dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së punës së Bordit të FHK-së.
4. Sekretari i Bordit të FHK-së është përgjegjës për mbajtjen e arkivit të Bordit të FHK-së pasi udhëheqë me punën e zyrës dhe për këtë caktohet njëri nga të punësuarit.

Neni 5

Punimet e Bordit të FHK-së

1. Anëtarët e Bordit të FHK-së për mbledhjet e Bordit njoftohen përmes ftesave fizike dhe/ose elektronike (e-mail, telefon), të cilat dërgohen shtatë (7) ditë para mbajtjes së mbledhjes, por mundet ne raste te ndryshme edhe së paku një ditë para mbajtjes së mbledhjes. Anëtarët e Bordit të FHK-së duhet ta konfirmojnë pranimin e ftesës dhe pjesëmarrjen në mbledhje gojarisht apo me shkrim.
2. Rendi i ditës për mbledhjet e Bordit të FHK-së dhe ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit të FHK-së, duhet t'i dërgohen të gjithë anëtarëve të të njëjtit së bashku me ftesën për mbledhjen e radhës.
3. Të gjithë anëtarët e Bordit të FHK-së kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen e ndonjë pike relevante në rendin e ditës për mbledhjen vijuese. Kjo kërkesë duhet t'i parashtrohet me shkrim Presidentit apo Sekretarit të Bordit, në formë fizike apo elektronike.
4. Mbledhjet e Bordit të FHK-së i kryeson Presidenti i tij. Në mungesë të tij, me autorizim paraprak me shkrim, mbledhjet e Bordit mund t'i kryesojnë nën/Presidenti i FHK-së apo ndonjë anëtar i Bordit të FHK-së.
5. Në mbledhjet e Bordit të FHK-së, për secilën pikë të rendit të ditës çdo anëtarë ka të drejtë të diskutojë vetëm njëherë dhe atë jo më gjatë se 5 (pesë) minuta. Replika lejohet vetëm nëse emri i anëtarit është apostrofuar dhe mund të zgjatë jo më shumë se 2 (dy) minuta. Kryesuesi i mbledhjes mund të lejojë përjashtim nga kjo dispozitë, në rast se atë e konsideron të dobishme për mbarëvajtjen e punës së Bordit të FHK-së.
6. Në rast të mosrespektimit dhe mospërfilljes së paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni, Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë t'i merr fjalën anëtarit.
7. Për të gjitha mbledhjet e Bordit të FHK-së mbahet procesverbali nga Sekretari i FHK-së, apo në mungesë të tij nga ndonjëri prej anëtarëve të Bordit apo nga zyrtarët punonjësit e zyrës) që cakton Sekretari për këtë mbledhje me shkrim.

Procesverbali duhet t'i përmbajë të gjitha vendimet e nxjerra nga Bordi si dhe të gjitha diskutimet relevante në favor apo kundër vendimeve përkatëse.

8. Procesverbali i mbledhjeve të Bordit mbahet në formë të plotë arkivat e FHK-së, ndërsa ekstrakti i të njëjtit i dërgohet të gjithë anëtarëve të Bordit, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.
9. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit bëhet në mbledhjen e parë vijuese të tij, si pikë e parë e rendit të ditës.

Neni 6

Vendimet e Bordit të FHK-së

1. Vendimet e Bordit të FHK-së mund të merren me shumicë votash në njërin nga dy mënyrat në vijim:
 - a) Në mbledhje të Bordit të FHK-së, në të cilën të pranishëm janë së paku shumica e anëtarëve të Bordit të FHK-së. Vendimet e Bordit të FHK-së do të jenë të vlefshme në rast se për to votojnë shumica e anëtarëve të Bordit të FHK-së të pranishëm në mbledhjen në fjalë.
 - b) Përmes deklarimit elektronik të anëtarëve të Bordit të FHK-së, me ç'rast vendimet janë të vlefshme vetëm në rast se për miratimin e tyre deklarohen shumica e të gjithë anëtarëve të Bordit të FHK-së. Materialet përcjellëse dhe forma e projektvendimit që mëtohet të nxirret përmes formës së përcaktuar në këtë nënparagraf duhet të dërgohen së paku një ditë para afatit të përcaktuar për deklarim elektronik.
 - c) Asnjë anëtarë i Bordit nuk mund të abstenojë në votim, por duhet të votojë pro apo kundër. Kurse në rastet kur kemi të bëjmë me votim të barabartë, vota e presidentit përcakton vendimin definitiv.
2. Propozimet për nxjerrjen e vendimeve sipas formës së përcaktuar në nënparagrafin b) të paragrafit 1 të këtij neni i bën Presidenti i Bordit të FHK-së, ndërsa i administron Sekretari i Bordit të FHK-së.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore e Punës së Bordit të Federatës së Hendbollit të Kosovës hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i FHK-së dhe nënshkrimit nga Kryetari i Bordit të FHK-së.

Prishtinë,
01 Tetor 2022.



Eugen Saraçini
President i Bordit të FHK-së